



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA**

Nr. Prot. 504

Tiranë, më 23/12/2019

VENDIM

Nr. 45 datë...23.12.2019

PËR

**NGRITJEN E NJËSISË SË KËRKIM-STUDIMIT NË FUSHËN E GJEOFIZIKËS
E SIZMIOLOGJISË**

Mbështetur në nenin 19 të ligjit nr. 53/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë" dhe 45 të Statutit të ASH, pranë ASH, me propozim të prof. Shyqyri Aliaj e pëlqimit të Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike, Kryesia e ASH në mbledhjen e saj të datës 18 dhjetor 2019,

V e n d o s i:

1. Të ngrihet një njësi kërkim-studimi në fushën e sizmiologjisë, gjeofizikës e të ndërtimit.
2. Njësia përbëhet nga prof. Shyqyr Aliaj, drejtues shkencor i njësisë, Markel Baballëku, specialist në fushën e inxhinierisë së tërmeteve e Skënder Allkja, drejtor teknik i kompanisë "ALTEA GEOSTADIS 2020", kompani gjeoteknike.
3. Objekti i punës së njësisë është përcaktimi i masave e hartimi i akteve që duhen ndërmarrë e miratuar për futjen e eurokodeve për sigurimin e standardeve në projektimin e strukturave ndërtimore të qëndrueshme ndaj tërmeteve, sipas klasifikimit të objekteve në fushën e ndërtimit.
4. Veprimtaria e njësisë do të kryhet në dy faza. Së pari, përgjithësimi dhe evidentimi i akteve për bërjen efektive e detyruese ligjërish të rezultateve të studimit të kryer nga prof. Shyqyri Aliaj, Eduard Sulstarova, Siasi Koçiu e Betim Muço brenda një periudhe 2-3 mujore. Më tej njësia do të vazhdojë me hartimin e propozimeve konkrete për masat që duhen marrë nga KM e institucionet përkatëse për të kryer zbatimin e plotë të eurokodeve për ndërtim në Shqipëri.
5. Koha e veprimtarisë së njësisë është 6 muaj me mundësi rizgjatjeje 6 muaj të tjerë.

6. Pranë njësisë do të ftohen si konsulentë specialistët ndër më të njohurit në fushën e ndërtimit e të sizmologjisë sipas propozimit të njësisë.
7. Konkluzionet e propozimet e njësisë do të paraqiten në KM e Komitetin Shtetëror të Rindërtimit.
8. ASH jep mbështetjen logjistike e mbulon shpenzimet financiare për veprimtarinë e njësisë, përfshirë ato për ribotimin e studimit në 200 kopje.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI

